



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr.70, datë 20/12/2005

**“MBI PAKËSIMIN E FONDEVE PËR INVESTIME TË OBJEKTIT
“NDËRTIMI I PARKUT QËNDROR TIRANË (FAZA E PARË)” DHE
SHITESË NË FONDIN E INVESTIMEVE PËR OBJEKTIN “NDËRTIM
RRUGE DHE KUZ NË RRUGËN “SIRI KODRA” (NGA KRYQËZIMI ME
RRUGËN BESA-LUME)”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 19, pika 9 dhe neni 32, gërma “dh”, Ligjit Nr. 7776, datë 22/12/1993 “Për Buxhetin Lokal” neni 18, ndryshuar me Ligjin Nr. 8399, datë 09/09/1998, Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.12, dt.21/03/2005 “Për miratimin e realizimit të buxhetit për vitin 2004 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2005”, me kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I;

1. Të miratojë pakësimin e fondit për investime për objektin “Ndërtimi i Parkut Qëndror Tiranë (faza e parë) në shumën 42.000.000 lekë dhe duke shtuar me të njëjtën shumë fondin e investimeve për vitin 2005 për objektin “Ndërtim rruge dhe kuz në rrugën “Siri Kodra” (nga kryqëzimi me rrugën Besa-Lume), sipas Tabelës Nr.1, pjesë përbërëse e këtij Vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI